



Aplikim për vizë me qëllim punësimi si babysitter (Au-Pair)

Në parim vlen si më poshtë:

1. Moshë minimale për një punësim si baby-sitter (Au-Pair) është 18 vjeç, ajo **maksimale 26** (ditën e aplikimit për vizë).
2. Mes aplikuesit/es për au-pair dhe prindërve pritës **nuk duhet të ketë marrëdhënie fafesisnie**. Në familjen pritëse flitet **gjermanisht si gjuhë amtare**. Nëse gjermanishtja atje flitet vetëm si gjuhë e huaj dhe jo si gjuhë amtare, atëherë viza mund të lëshohet vetëm nëse au-pair nuk vjen nga i njëjti vend i origjinës me prindërit pritës.
3. Qëndrimi si au-pair në Gjermani në parim është **i mundur vetëm një herë**.

I gjithë dokumentacioni duhet të paraqitet në origjinal!

Të gjitha dokumentat që tërhiqen pranë Ambasadës (fletët e informacionit, formularët e aplikimit) janë gratis. Të gjitha informacionet rreth procedurës së aplikimit i gjeni në faqen e internetit të Ambasadës: www.tirana.diplo.de.

Lutemi të vini re udhëzimet e dhëna për çdo pikë, në mënyrë të veçantë numrin e kopjeve të nevojshme.		
1.	Pashaporta e udhëtimit <i>+ 2 kopje (të gjitha faqet e rëndësishme)</i>	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.
2.	2x formularë aplikimi për vizë	Në gjermanisht ose anglisht, të plotësuara në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkuara personalisht. Jo aplikime për viza Schengen!
3.	3x fotografi	3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj.
4.	Tarifa	Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhet kesh në monedhën shqiptare LEK . Tarifa është 75 Euro përlllogaritur me kursin aktual të këmbimit.
5.	Jetëshkrim <i>+ 2 kopje</i>	Në origjinal – Jetëshkrimi duhet të hedhë një vështrim në jetën dhe përvojat profesionale.
6.	Shkresë motivimi <i>+ 2 kopje</i>	Shkresë motivimi në origjinal, e formuluar në shqip me përkthim në gjuhën gjermane

7.	Kontrata e angazhimit si babysitter (au-pair) <i>+ 2 kopje</i>	<p>Në origjinal, në gjuhën gjermane ose angleze. Një kontratë-model mund të shkarkohet nga faqja e internetit e Agjencisë Federale të Punës www.arbeitsagentur.de</p> <p>Kontrata duhet të përmbajë kushtet minimale për marrëdhënien Au-Pair:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimin e saktë të palëve në kontratë • Numrin dhe moshën e fëmijeve që duhen shoqëruar (në familje duhet të jetojë të paktën një fëmijë minoren) • Fillimi dhe kohëzgjatja e kontratës (të paktën 6 muaj, maksimumi 1 vit) • Detyrimet e përgjithshme të prindërve pritës • Detyrimet e përgjithshme të Babysitter-it • Detyrimi i prindërve pritës për lidhjen e një kontrate sigurimi për shëndetin, shtatzaninë, lindjen dhe aksidentet. • Marrëveshja për shumën e parave të xhepit (në muaj të paktën 260 euro, plus para xhepi për frekuentimin e një kursi gjuhe) • Marrëveshje për kohën e punës (maksimumi 6 orë në ditë dhe 30 orë në javë) • Marrëveshje për ditët e pushimit (të paktën 2 ditë pune në muaj) 	
8.	Dëshmi për njohuritë e gjermanishtes	<p>Nisur nga një vendim i Bundestag-ut Gjerman i vitit 2003 për përmirësimin e ndërmjetësimit Au-Pair me qëllim ndalimin e efektshëm të rasteve të shfrytëzimit dhe abuzimit, në momentin e aplikimit do të realizohet një test i gjuhës gjermane, me gojë, në nivelin minimal A1.</p>	

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.